



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5128 / 13 prot.

Pogradec, më 27, 12, 2023

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola Kamolli
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues,

“PËR DHËNIE NDIHMË FINANCIARE PËR PUNONJËSIN Z. DHIMITRAQ GJATA”

Me respekt,

KRYETARI

Ilir KHAKOLLI

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit:

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ .Prot

Datë ____ . ____ 2023

PROJEKT- VENDIM

NR. __ , DATË __ . __ .2023

“PËR DHËNIE NDIHMË FINANCIARE PËR PUNONJËSIN Z. DHIMITRAQ GJATA”

Në mbështetje të nenit 8, pikes 1.3.a të nenit 9, të shkronjës “dh” të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikës 132 të udhëzimit nr. 9 , date 20.03.2018 “Për procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.144, datë 28.12.2022, ”Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2023”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare në masën 200.000 (treqind mijë lekë) për arsye se Z. Dhimitraq Gjata ndodhet në gjendje të rënduar shëndetësore .
2. Ky fond përballohet nga fondi rezerve i parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Pogradec për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.
4. Vendimi të hyjë në fuqi menjëherë mbas lajmërimit të subjektit/individit.

K R Y E T A R E

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ prot.

Pogradec, më __, __, 2023

RELACION

Z. Dhimitraq Gjata i datëlindjes 03.04.1964 me vendbanim në Pogradec, është emëruar pranë Institucionit të Bashkisë Pogradec në datën 01.01.1997, në pozicionin “Përgjegjës i seksionit të shërbimeve”, dhe aktualisht është “Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimit të territorit” Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Kategoria e pagës III-b.

Në muajin Qershor 2023 Z.Dhimitraq, pësoi krizë celebrale duke mos qënë në gjëndje për të vazhduar aktivitetin e tij ditor. Pas një lufte disa mujore Z. Dhimitraq arriti ta mposhte sëmundjen e tij por duke ndjekur një kurë e cila kushton.

Bashkia Pogradec, për kontribut e dhënë përgjatë 25 vite pune, kërkon nga ana juaj miratimin e fondit prej 200,000 lekë për të përballuar shpenzimet për kurimin e tij.

Konceptoi: Irsa Karapança

KRYETAR

ILIR XHAKOLLI